



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 832 / prot.
3

Vlorë, më 14. 05. 2021

VENDIM

Nr. 21, datë 12. 05. 2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT "BACHELOR NË MEDIA-
KOMUNIKIM DHE TRASHËGIMI KULTURORE ME PROFILET:
GAZETARI DHE MULTIMEDIA; TRASHËGIMI KULTURORE",
APLIKUAR PËR VITIN AKADEMIK 2021- 2022

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, shkronja dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës, 12. 05. 2021

VENDOSI:

1. Të miratoje Rregulloren e programit "**Bachelor në media, komunikim dhe trashëgimi kulturore, me profilet: Gazetari dhe multimedia; Trashëgimi kulturore**", aplikuar për vitin akademik 2021- 2022 (sipas rregullores bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË *BACHELOR* NË
"MEDIA, KOMUNIKIM E TRASHËGIMI KULTURORE ME PROFILET: GAZETARI
DHE MULTIMEDIA; TRASHËGIMI KULTURORE"**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë *Bachelornë* "Media, Komunikim dhe Trashëgimi kulturore me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" vendos rregullat normative të funksionimit të programit dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë shkollore. Rregullorja përcakton misionin e programit, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve dhe të bashkëpunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së programit.

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është neni 102 i Kushtetutës, ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe udhëzimi nr.15, datë 04.04.2008 i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

Neni 4

Subjektet

Subjektet e kësaj rregulloreje janë organet drejtuese të departamentit, personeli akademik dhe administrativ, kordinatorët, studentët dhe bashkëpunëtorët e programit.

KREU II

STATUSI, MISIONI DHE VEPRIMTARIA E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 5

Statusi i programit

2 5.1. Programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore", është program i veçantë në strukturën akademike të universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

5.2. Programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" zhvillohet me kohë të plotë dhe në përfundim të tij e pajis studentin që ka plotësuar të gjitha detyrimet e programit me diplomën *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore"

5.3. Për mbarëvajtjen e veprimtarisë së programit të studimit kanë përgjegjësitë përkatëse Rectorati i universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Gjuhë-Letërsisë.

Neni 6

Misioni i programit të studimit

Programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" ka si mision:

a. Të përgatitë specialistë të lartë dhe studiues për fushën e Medias, Komunikimit e Trashëgimisë kulturore;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

- b. Të mbështetë kultivimin e vlerave që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave;
- c. Të kontribuojë në rritjen e rolit të mediave në forcimin e demokracisë, si dhe në përvetësimin, ruajtjen dhe identifikimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

Neni 7

Veprimtaria e programit të studimit

7.1. Aspektet kryesore të veprimtarisë së programit të ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore janë: mësimdhënia, kërkimi, dialogu akademik dhe botimet.

7.1.1. Veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve mësimore bashkëkohore, të bazuara në modelet e institucioneve të arsimit të lartë.

7.1.2. Veprimtaria kërkimore është e orientuar kryesisht në studimin e çështjeve të fushës së medias, komunikimit e trashëgimisë kulturore, si dhe realizohet nëpërmjet tezave dhe projekteve të kërkimit.

7.1.3. Institucioni ofron botime të llojeve të ndryshme në funksion të programeve që ofron, të propagandimit të veprimtarisë së universitetit dhe në mbështetje të procesit të demokratizimit të vendit.

7.2. Programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" e zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të një strategjie zhvillimi.

Neni 8

Parimet

8.1. Veprimtaria e programit i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" zhvillohet në bazë të parimeve të lirisë akademike, të autonomisë institucionale, të cilësisë, të efektshmërisë dhe të efijencës.

8.2. Liria akademike nënkupton mungesën e ndërhyrjes nga jashtë, të censurës dhe të barrierave në praktikën e veprimtarisë akademike. Ajo vështrohet si një parakusht për mendimin kritik, krijues si dhe për avancimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

8.3. Autonomia institucionale i referohet shkallës së vetërregullimit dhe të pavarësisë së saj, sipas së cilës:

- a) miraton vetë strategjinë e zhvillimit;
- b) miraton vetë programet mesimore;
- c) ngre këshilla dhe komisione për realizimin e misionit të saj;
- d) ka të drejtën e përdorimit të ndërtesave dhe të pasurive të tjera të dhëna nga universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ose dhurues të ndryshëm sipas legjislacionit në fuqi.

8.4. Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, manaxhuese, të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave, ashtu edhe të pritshmërive, të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Zbatimi i parimit të cilësisë nënkupton realizimin e vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit, të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së univesitetit.

8.5. Efektshmëria nënkupton funksionimin në një mënyrë të tillë që çon drejt realizimit të qëllimeve dhe objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që gjërat të bëhen sipas një strategjie të parashikuar.

8.6. Parimi i efijencës nënkupton që universiteti të arrijë rezultate të mira me kosto të pranueshme për shoqërinë, të përdorë burimet njerëzore, materiale dhe mjetet në mënyrë optimale.

KREU III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT

Neni 9

Struktura organizative dhe drejtuese

Programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore"me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore"ka këtë strukturë organizative dhe drejtuese:

1. Autoriteti drejtues: Përgjegjësi i departamentit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

2. Drejtuesit e seksioneve. Për çdo seksion përgjegjësi i departamentit cakton një pedagog përgjegjës, i cili ndjek nga afër funksionimin e procesit mësimor dhe sjell në departament shqetësimet dhe problemet e studentëve në lidhje me universitetin.

3. Personeli akademik.

4. Administrata: Sekretar,i/-ja.

Neni 10

Drejtuesi i programit

Autoriteti drejtues i programit të studimit është përgjegjësi i departamentit. Ai përgjigjet për përmbushjen e misionit të programit dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtarinë e gjithanshme në kuadër të programit. Përgjegjësi i departamentit:

a) Drejton punën për hartimin, ndryshimin e rregullores së programit; për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik të departamentit: planin mësimor, programet mësimore, paketën e praktikës dhe të udhëzimeve për diplomën; për hartimin e planit të kërkimit, për administrimin e të ardhurave të institucionit.

b) Miraton programet mësimore.

c) Drejton hartimin e orarit të mësimave, të provimeve dhe ndjek zbatimin e tyre.

d) Ngre komisionet e provimeve.

e) Ndjek ecurinë e procesit mësimor.

f) Ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe të procesit të diplomës.

g) Organizon ceremoninë e diplomimit.

h) Miraton kriteret e pranimit të studentëve, komisionet e pranimit të studentëve, komisionet e diplomimit.

i) Organizon procedurat e pranimit të studentëve të rinj dhe shpall fituesit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

- j) Miraton kriteret e pranimit dhe kandidaturat e personelit akademik dhe të personelit ndihmës të shkollës.
- l) Organizon takime pune çdo javë me personelin akademik.
- m) Firmos akte dhe shkresa zyrtare në emër të Departamentit.
- n) Ndjek ecurinë e botimeve shkencore dhe pedagogjike.
- o) Ndjek bashkëpunimin me partnerët.
- p) Propozon në Dekanat masat ndëshkimore për pedagogët dhe studentët që shkelin rregulloren.
- q) Përfaqëson Departamentin në marrëdhëniet me të tretët.
- r) Organizon vlerësimin e brendshëm të programit.
- s) Vlerëson punën e pedagogëve dhe të sekretarit.
- t) Paraqet çdo vit mësimor raportin e veprimtarisë së Departamentit.

Neni 11

Komisionet

11.1 Autoriteti drejtues ngre komisione të ndryshme që kryejnë detyra të caktuara lidhur me pranimin e studentëve, me zhvillimin e provimeve, me përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës, me strategjinë e zhvillimit të universitetit etj. Komisionet propozohen në mbledhjen e departamentit dhe miratohen nga autoriteti drejtues i tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Neni 12

Personeli akademik

12.1. Personeli akademik përbëhet nga profesorati që zhvillon mësim në programin eciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore".

12.2. Në programin eciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore", si rregull, pranohen të japin mësim pedagogë që zotërojnë titullin profesor, profesor i asociuar, që zotërojnë gradën shkencore "Doktor" ose janë në procesin e mbrojtjes së doktoratës. Por për vetë specifikat e programit të ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore", në procesin e mësimdhënies mund të përfshihen edhe individë që kanë diplomë *Bachelor*, por që janë figura të njohura të medias në vend apo specialistë të mirënjohur të fushës dhe që angazhohen në lëndë të karakterit praktik.

12.3. Kriteret e punësimit të personelit akademik propozohen dhe miratohen nga Departamenti. Rregullat e procedurat e mëtejshme për përzgjedhjen e personelit akademik bëhen mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Statusin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

12.4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pedagogëve a) Të kenë në dispozicion gjithë informacionin e nevojshëm për realizimin e detyrave të tyre. b) Të përdorin të gjitha mjediset dhe pajisjet e institucionit për veprimtari në dobi të universitetit. c) Të marrin pjesë në komisione dhe veprimtari të ndryshme të universitetit. d) Të kualifikohen në kuadrin e projekteve të universitetit. e) Të zbatojnë kontratën e punës f) Të zbatojnë rregulloren e programit të ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" dhe të universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. g) Të bashkëveprojnë në një mënyrë profesionale, qytetare me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët e universitetit "Ismail Qemali". h) Të realizojnë programin mësimor sipas kërkesave të paracaktuara. i) Të krijojnë një klimë bashkëpunimi me studentët dhe kolegët. j) Të kontribuojnë në çështjet e integritetit evropian të vendit. k) Të vlerësojnë studentët në mënyrë profesionale dhe në kohën e parashikuar. l) Të mos angazhojnë studentët për punë personale dhe të mos krijojnë me studentët marrëdhënie të jetës private, gjatë kohës që ata janë duke ndjekur programin e studimeve.

Adresa /Adress: L. HajroCakërri, Rr. SulejmanDelvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax: ++35533224952





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

Neni 13

Sekretar,-i/-ja

Sekretar,-i/-ja mësimor,-e kryen detyrat si më poshtë: a) Punon nën drejtimin e autoritetit drejtues dhe mban përgjegjësi për zbatimin e të gjitha porosive të dhëna prej tij për komunikim shkresor e gojor me Dekanatin, me personelin akademik, me studentët, me bashkëpunëtorët e shkollës. b) Bën organizimin teknik të mbledhjeve të departamentit dhe mban procesverbalin e mbledhjeve. c) Ndihmon në përgatitjen e materialeve për autoritetin drejtues. d) Shërben në protokollin e organizuar në departament për delegacione zyrtare shqiptare ose të huaja. e) Pret personat që kërkojnë takim me përgjegjësin e departamentit. f) Merr në dorëzim korrespondencën dhe materiale të tjera që vijnë në adresë të përgjegjësit të departamentit. g) Arkivon apo dorëzon në arkiv dokumentacionin përkatës të pedagogëve dhe të studentëve. h) Shtyp dhe shumëfishon shkresa dhe materiale mësimore. i) Ndjek ecurinë e procesit mësimor në drejtim të respektimit të strukturës mësimore, të orarit të mësimit, të provimeve; ecurinë e praktikës, të procesit të tezës dhe kujdeset për mbajtjen e dokumentacionit përkatës të këtyre

proceseve. j) Përgatit mjetet mësimore për zhvillimin e procesit mësimor. k) Bën pajisjen me kancelari e materiale të tjera të domosdoshme që i duhen institucionit. l) Afishon strukturën mësimore, orarin e mësimit, datat e provimeve, datat e praktikës, të mbrojtjes së diplomave dhe lajmërimi për veprimtari të ndryshme. m) Pajis të gjithë studentët e rinj të pranuar në program me kartë studenti, plotëson kërkesat e studentëve për vërtetime të thjeshta, e dokumente të tjera. n) Mban lidhje me Dekanatin dhe raporton të dhënat statistikore të programit në instancat që i kërkojnë. o) Merr masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit nga rreziqet e ndryshme si zjarri, uji, dëmtimet, shpërdorimet etj. p) Në fund të vitit akademik përgatit një raport pune të cilin ia paraqet përgjegjësit të departamentit.

KREU IV

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 14

Afati i studimeve





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

14.1. Afati i rregullt i studimeve në programin eciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" është tri vite akademike pa shkëputje nga puna.

41.2. Afati i rregullt i mbrojtjes së diplomës është në fund të vitit të tretë pas përfundimit të studimeve.

Neni 15

Ndërpreja dhe rifillimi i studimeve

15.1. Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë për arsye personale dhe mund t'i rifillojë ato duke respektuar rregulloren e programit të studimit.

15.2. Në çdo rast studenti është i detyruar t'i paraqitë institucionit një kërkesë për ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve.

15.3. Studenti mund të rifillojë studimet në atë periudhë të vitit akademik ku i ka ndërprerë studimet ose në fillim të vitit akademik.

Neni 16

Lëvizja e studentëve

16.1. Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe të projekteve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë institucioni. Ata mund të kryejnë praktikën në institucione ndërkombëtare jashtë shtetit ose kurse studimi në një nga universitetet partnere. Kjo lëvizje nuk merret si ndërprerje e studimeve dhe rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit.

Neni 17

Kohëzgjatja dhe organizmi i studimeve

17.1. Fillimi dhe mbarimi i vitit akademik për IAL-të publike caktohen nga Ministria e Arsimit.

17.2. Programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" realizohet në 3 (tri) vite akademike, i ndarë në gjashtë semestra gjatë të cilave studenti fiton 180 kredite. Një student i programit të ciklit të parë *Bachelor* nuk mund të diplomohet, nëse nuk ka mbushur numrin prej 180 kreditesh.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

17.3. Mënyra e ndjekjes së programit të studimit është "me kohë të plotë".

17.4. Në ditët e festave zyrtare nuk zhvillohet mësim ose provim.

Neni 18

Plani mësimor

18.1. Plani mësimor përfshin lëndët e detyrueshme të përgjithshme, lëndët specifike të profileve dhe lëndët me zgjedhje. Çdo lëndë ka numrin e vet të krediteve.

18.2. Plani mësimor ka karakter ndërdisiplinar.

18.3. Plani mësimor miratohet nga senati i universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

18.4. Plani mësimor ndryshohet vetëm kur ndryshimi është i argumentuar dhe në masën e parashikuar nga ligji.

Neni 19

Programi i lëndës

19.1. Programi i lëndës hartohet nga titullari i saj, sipas formatit standard, mbështetur në vendimet dhe udhëzimet përkatëse për institucionet e arsimit të lartë.

19.2. Programet lëndore miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

19.3. Secila lëndë ka kreditet përkatëse.

Neni 20

Format e mësimdhënies

20.1. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit e praktikës.

20.2. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75%, sipas nenit 53 të rregullores së Universitetit.

20.3. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Neni 21

Praktika

21.1. Komponenti i praktikës synon t'u japë studentëve një përvojë praktike të punës dhe t'u krijojë mundësi për të hulumtuar për çështjet që shtrën teza e tij dhe për të vendosur kontakte që do t'i ndihmojnë ata për realizimin e saj. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional, në atelietë praktike që janë pjesë e programit mësimor, si dhe në praktikën në institucione që lidhen me fushën e tij të studimit.

Neni 22

Punimi i diplomës dhe provimi

22.1. Do të pranohen të dy format e shlyerjes për ezaurim të plotë të ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore". Punimi i diplomës është punimi shkencor apo produksioni përfundimtar që studenti duhet të mbrojë për të fituar diplomën *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore", kurse provimi i referohet përgatitjes me tezë të studentit, i cili i referohet provimit përfundimtar me pyetje specifike, hartuar nga të gjitha lëndët e programit, pasqyruar në bandën e pyetje të programit të formimit.

22.2. Për punimin e diplomës janë caktuar 6 kredite.

22.3. Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së punimit të diplomës studenti duhet: a) Të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë, duke marrë numrin e krediteve të kërkuara; b) Të ketë paraqitur në kohë projektpropozimin e temës së diplomës apo produksionit përfundimtar dhe të ketë marrë miratimin përkatës nga udhëheqësi shkencor dhe përgjegjësi i departamentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

KREU V

VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 23

Procedura dhe kriteret të vlerësimit

23.1. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe u bëhen të ditura studentëve.

23.2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.

23.3. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5-a është nota minimale kaluese dhe 10-a maksimale.

23.4. Vlerësimi i punimit të diplomës bëhet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga pesë e lart janë kaluese.

23.5. Diploma *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" i jepet kandidatit që realizon me sukses detyrimet e planit mësimor, përfshirë edhe mbrojtjen e punimit të diplomës, ose shlyerjen e provimit me gojë.

Neni 24

E drejta për të hyrë në provim.

24.1. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor.

24.2. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.

24.3. Para se të paraqitet në provim, studentin duhet të jetë regjistruar në sistemin e elektronik.

Neni 25

Adresa /Adress: L. HajroCakërrri, Rr. SulejmanDelvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax: ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

Zhvillimi i provimeve

25.1. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e provimeve shpallen jo më vonë se një muaj përpara nga dita e fillimit të sezonit të provimeve.

25.2. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, përgjegjësi i departamentit, me urdhër me shkrim, cakton një datë tjetër të mëvonshme e cila u bëhet e njohur studentëve dhe pedagogëve.

25.3. Lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë disa pedagogë të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit.

Neni 26

Komunikimi i vlerësimeve

26.1. Vlerësimet për lëndë të veçanta komunikohen nga sekretaria mësimore.

26.2. Sekretaria mësimore u komunikon studentëve individualisht rezultatet e vlerësimeve në përfundim të çdo semestri.

26.3. Studenti mund të njihet me vlerësimet e lëndëve edhe përmes sistemit elektronik.

Neni 27

Riprovimi

26.1. Riprovimi në një lëndë të caktuar kryhet në sesionin e parashikuar për kursin pasardhës. Nuk lejohet riprovimi për të dytën herë brenda një sesioni.

Adresa /Adress: L. HajroCakërrri, Rr. SulejmanDelvina, Vlorë, Albania
Tel. Fax: ++35533224952

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

26.2. Studenti ka të drejtë të hyjë përsëri në provim për përmirësim të notës në një lëndë të vlerësuar pozitivisht. Studenti lejohet të hyjë vetëm në një provim përmirësimi në sezon.

Neni 28

Dokumentimi i vlerësimeve

28.1. Vlerësimet dokumentohen në procesverbalin e vlerësimit dhe në regjistrin e rezultateve.

28.2. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 3 ditë nga dita e provimit ose e prezantimit të detyrës së kursit, kur janë kurse me pak studentë dhe jo më vonë se 5 ditë me kurse të mëdha në numër.

28.3. Në asnjë rast procesverbali i vlerësimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.

28.4. Procesverbali duhet të përmbajë: firmën e pedagogut të lëndës, sekretares mësimore dhe të Dekanit ose Zëvendësdekanit

28.5. Një notë e raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezulton se është bërë një gabim gjatë regjistrimit ose gjatë hedhjes në kompjuter. Pedagogu duhet të dorëzojë një vërtetim me shkrim ku pranohet gabimi. Vërtetimi miratohet nga autoriteti drejtues. Ndryshimi pranohet brenda një periudhe kohore prej tri ditësh nga data e dhënies së vlerësimit. Kur shfaqen paqartësi në lidhje me ndonjë gabim të mundshëm të një note të paraqitur nga një pedagog, i cili nuk është më pjesëtar i trupës mësimore, përgjegjësi i departamentit ngre një komision të posaçëm për të zgjidhur problemin dhe autorizon ndryshimin e mundshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

KREU VI

DIPLOMIMI

Neni 29

Procedura e diplomimit

29.1. Mbrojtja e diplomës bëhet në dy sesione: i verës dhe i vjeshtës, të cilët përcaktohen në strukturën e studimeve. Me miratim të Dekanit, mund të aplikohet mbrojtje e diplomave edhe gjatë sezonit të dimrit.

29.2. Kandidati diplomant, i cili rrëzohet në sesionin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sesionin e ardhshëm.

Neni 30

Marrja e diplomës

30.1. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur punimin e diplomës pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me listën e notave të fituara gjatë viteve të studimit si dhe me diplomën plotësuese.

30.2. Diploma nënshkruhet nga dekani dhe rektori i Universitetit. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit.

30.3. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidencohet në regjistrin përkatës.

30.4. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari mund ta tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, nëse i humbet origjinali ose i dëmtohet ai, duke iu bërë i papërdorshëm, Universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave dhe e krediteve të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga dekani i fakultetit dhe rektori. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit.

30.5. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

KREU VII

PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 31

Pranimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve

31.1. Pranimi i studentëve në programin e studimit të ciklit *Bachelor* është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

31.2. Departamenti mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga IAL-ja dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

31.3. Në fillim të vitit akademik, IAL-ja dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.

Neni 32

Dokumentacioni i pranimit

32.1 Kandidati që kërkon të ndjekë studimet për nivelin Bachelor duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme: a. Diplomë e shkollës së mesme b. Dëftesë e notave të shkollës së mesme (autentike ose të fotokopjuar dhe të noterizuar). c. Certifikatë lindjeje me fotografi d. Curriculum vitae. e. Kërkesë me shkrim dhe letër motivimi ku të shprehë qartë qëllimin e ndjekjes së studimeve. Mandat pageze nga bankapër taksëne regjistrimit.

KREU VIII

STUDENTËT

Neni 33

Statusi i studentit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

33.1. Kandidati fitues ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik për të cilin konkurroi

nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të institucionit, brenda afateve të parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit të nivelit *Bachelor* dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij.

33.2. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës ose me përjashtimin e personit nga Universiteti.

Neni 34

Të drejtat e studentëve

34.1. Studentët kanë këto të drejta: a) Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluarat qartë dhe të justifikuara në aspektin akademik. b) Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik. c) Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e shkollës. d) Të përdorin pajisjet e institucionit, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor, bibliotekën dhe internetin; e) Të paraqesin pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi. f) Të përfaqësohen në organet drejtuese të Universitetit. g) Të marrin pjesë në vlerësimin e veprimtarisë së institucionit. h) Të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin akademik dhe profesional.

Neni 35

Përgjegjësitë e studentëve

35.1. Studentët kanë këto përgjegjësi: a) Të njohin dhe të zbatojnë rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, kërkesat e planit dhe të programeve mësimore, si dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt institucioni nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre. b) Të sillen në një mënyrë të pjekur, profesionale, qytetare në tërë ndërveprimet në universitet me drejtuesit, personelin akademik dhe administrativ, studentët e tjerë dhe bashkëpunëtorët e institucionit. c) Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve mësimore, të praktikës dhe të punimit të diplomës. d) Të kontribuojnë në zhvillimin e institucionit dhe krijimin e një klime pozitive në Universitet. e) Të respektojnë kohën e pedagogëve. f) Të paguajnë taksën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit në afatet e caktuara. g) Të mbajnë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tyre, dëmi material që mund t'i shkaktojë institucionit; zhdëmtohet në masën që e gjykon Departamenti.

Neni 36

Përgjegjësitë e institucionit për studentët

- a) Universiteti u jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me statusin, rregulloren, strategjinë e zhvillimit të tij, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, rregullat e praktikës, rregullat e mbrojtjes së tezës, tarifën e shkollimit.
- b) Universiteti respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, kërkimin, vlerësimin.
- c) Universitetinxit studentët të marrin pjesë në veprimtaritë e tij.
- d) Universitetindihmon studentët në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e planit mësimor dhe krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

KREU IX

MASAT DISIPLINORE

Neni 37

37.1. Shkelje e rregullave të institucionit quhen të gjitha veprimet e kryera nga ana e subjekteve që veprojnë në universitet dhe që çënojnë personalitetin e subjekteve të tjera që veprojnë në universitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

37.2. Si veprime të ndëshkueshme quhen falsifikimi i dokumentave të ndryshme, kopjimi në provime, plagjiatura, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes, shkelja e rregullores etj.

37.3. Ndaj personave që kryejnë këto veprime merren këto masa disiplinore: a) vërejtje me shkrim; b) përjashtim nga universiteti për një vit; c) përjashtim nga universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës.

37.4. Masa e parashikuar në pikën (a) merret nga përgjegjësi i departamentit. Masa e parashikuar në pikën b) merret nga Dekanati me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe masa e parashikuar në pikën c) merret nga rektori i UV-së.

37.5. Asnjë ndëshkim nuk mund të zbatohet pa u dëgjuar më parë personi që do të ndëshkohet.

37.6. Vendimet mund të ankimohen pranë Rektoratit brenda pesë ditëve nga dita e komunikimit të tyre. Ankimi i bërë nuk pezullon zbatimin e masës.

37.7. Masat disiplinore për personelin e akademik dhe administrativ janë parashikuar në statusin dhe rregulloren e universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

KREU X

FINANCIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 38

Administrimi i të ardhurave

39.1. Administrimi i të ardhurave që krijon programi i ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" bëhet në bazë të vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, udhëzimeve të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vendimeve të senatit të UV-së dhe të drejtuesit të Bordit të Administrimit të universitetit.

Neni 39

Tarifa e shkollimit

39.1. Tarifa e shkollimit për programin e ciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore" profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" miratohet nga instancat përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

39.2. Tarifa e shkollimit mund të paguhet me këste, sipas vendimit të Senatit Akademik të universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

39.3. Studenti është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës së shkollimit në datën e caktuar. Studentit që nuk kryen pagesën e tarifës së shkollimit në afatin e caktuar i hiqet e drejta për të vazhduar studimet.

39.4. Tarifa e regjistrimit për konkursin e pranimit. Secili kandidat që dëshiron të regjistrohet për konkursin e pranimit në programin eciklit të parë të studimit *Bachelor* në "Media, Komunikim e Trashëgimi kulturore me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore" duhet të paguajë në ditën e regjistrimit një tarifë të caktuar. Kjo tarifë regjistrimi është e pakthyeshme për kandidatët që nuk fitojnë të drejtën e studimit. Fletëpagesa e tarifës së regjistrimit duhet të shoqërojnë dokumentin e aplikimit dhe të përfshihet në dosjen e kandidatit.

KREU XI

PRONËSIA INTELEKTUALE

Neni 40

40.1. Departamenti ka të drejtën e pronësisë intelektuale dhe të drejtën e autorësisë për kërkimet, për botimet, për videot, projektet dhe produktet e tjera të përgatitura nga personeli dhe studentët e tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË**

KREU XII

VLERËSIMI I BRENDSHËM

Neni 41

41.1. Departamenti kryen çdo dy vjet vlerësimin e brendshëm.

KREU XIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42

42.1. Kjo rregullore mund të përsoset e të korrigjohet, gjatë punës në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër institucioni ose ndryshimet në strukturën e administratës, me anë të amendamenteve të ndryshme bashkëngjitur asaj me firmën e Përgjegjësit të Departamentit ose duke u ripunuar tërësisht. Një kopje e kësaj rregulloreje depozitohet në protokoll.

42.2..Dispozita të veçanta

Departamenti i Gjuhë-Letërsisë dhe njësitë e tjera bashkëpunuese në këtë program kanë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje.

Drejtuesi i Departamentit Gjuhë-Letërsisë

Prof.as.dr Monika Hasani

